VENDIM
Nr. 213, datë 27.9.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHTATOR 2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. nr. 144, datë 25.6.2018, mbi rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit", për muajin shtator 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 17494 prot., datë 14.9.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s. 144, datë 25.6.2018, mbi rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", pikërisht nenit, të rishikuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Duke u mbështetur në formulën përllogaritëse të nenit 8 të metodologjisë së sipërcituar, OSHEE sh.a., ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018, si vijon:

Çmimi FMF i llogaritur nga OSHEE sh.a për muajin Shtator 2018			
a.	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	8.5652	Lekë/kWh
b.	Kthimi për riskun (në përqindje)	0.26	Lekë/kWh
c.	**Çmimi maksimal i blerjes për periudhën në fjalë**	**8.82**	**Lekë/kWh**
d.	Kosto administrative e FMF	1.79	Lekë/kWh
e.	Tarifa e përdorimit të rjetit të transmetimit	0.75	Lekë/kWh
f.	Tarifa e përdorimit të rjetit të shpërndarjes në 35 kV	1.5	Lekë/kWh
Çmimi i energjisë elektrike aktive (c + d + e + f)		**12.86**	**Lekë/kWh**

- Bashkëngjitur këtij aplikimi, OSHEE sh.a. ka paraqitur komunikimin shkresor (nr. 2210 prot., datë 4.9.2018) nga drejtori i Departamentit të Tregtimit të Energjisë Elektrike, në lidhje me sigurimin e sasisë së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për klientët e lidhur në 35 kV, të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018.

- Në bazë të vendimit nr. 19, datë 19.1.2018 të Bordit të ERE-s, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018", çmimi për blerjen e energjisë nga prodhuesit me përparësi për vitin 2018 është 8.5652 lekë/kwh.

- Për sa deklarohet nga OSHEE sh.a., me shkresën nr. 8814/1, datë 24.5.2018, se: "OSHEE sh.a. nuk ka ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit dhe shpërndarjes dhe vijon të mos ketë ndarje të tyre edhe sot" dhe, se: "OSHEE nuk ka pasur një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe atyre të disbalancave për klientët e FMF-së", është e arsyeshme që, për sa kohë që nuk ka ndarje të llogarive midis aktiviteteve, si dhe mungesa e një strukture për evidentimin e kostove për klientët FMF, me qëllim përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës), të pranohet si e arsyeshme kostoja për njësi prej 1,79 lekësh/kwh, e paraqitur nga OSHEE sh.a., si më sipër.

- Në vijim, me ndarjen administrative/ organizative të OSHEE sh.a., sipas aktiviteteve do të jetë i mundur saktësimi i këtyre kostove dhe axhustimi i tyre për periudhat e mëparshme, në përputhje me "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin nr. 210, datë 28.12.2017, "Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018" është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin nr. 190, datë 30.8.2018, "Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018" është 1.5 lekë/kwh.

- Në përfundim, nga verifikimi i informacionit dhe i përllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin shtator 2018 është 12.86 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit prej 12,86 lekësh/kwh për muajin shtator 2018.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti